

MARINA RESIDENCES VLORË
TIRANË FARKË LUNDËR LOBBY HOME, RRUGA NACIONALE
TIRANË- ELBASAN, PËRBALLË QENDRËS TREGTARE TEG
M12103049U

Sot, më datë 06.12.2023, në selinë e Shoqërisë **"Marina Residences Vlorë"** SH.P.K. me NUIS M12103049U (referuar në vijim si **"Shoqëria"**), në adresën "Tiranë Farkë Lundër Lobby Home, Rruga Nationale Tiranë- Elbasan, Përballe Qendrës Tregtare TEG" u paraqitën palët e mëposhtme ortakë të Shoqërisë:

- **"Marina Di Valona"** SH.P.K. një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar pranë Qëndres Kombëtare të Biznesit me NUIS M01324008A me seli në adresën: "Tiranë Farkë Lundër Lobby Home, Rruga Nationale Tiranë- Elbasan, Përballë Qendrës Tregtare TEG", përfaqësuar nga administratori Znj. Eranda Muskaj - ortak i Shoqërisë dhe zotërues i 72% (shtatëdhjetë e dy përqind) të kapitalit themeltar të saj (në vijim **"Marina di Valona"**)
- **"Brunes"** SH.P.K. një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar pranë Qëndres Kombëtare të Biznesit me NUIS K37125203H me seli në adresën: "Tiranë Durrës km 7", përfaqësuar nga administratori Z. Geront Çela - ortak i Shoqërisë dhe zotërues i 18% (tetëmbëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të saj (në vijim **"Brunes"**).
- **BALFIN - Balkan Finance Investment Group SH.P.K.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli në adresën: Rruga "Papa Gjon Pali II". Ndërtesa Nr. 12, Kati 11, Zyra 1106, Tiranë, Shqipëri, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS K72223031K, përfaqësuar nga Znj. Edlira Muka - ortak i Shoqërisë dhe zotërues i 10% (dhjetë përqind) të kapitalit themeltar të saj (në vijim **"Balfin"**).

Znj. Eranda Muskaj, e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton Znj. Itena Ndroqi, e cila pranon, të kryejë funksionin e sekretarit.

Znj Eranda Muskaj në cilësinë e Kryetarit, verifikon vullnetin e ortakëve për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, duke e deklaruar Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

Rendi i Ditës

I. Miratimi i revokimit i vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërise me datë 15.06.2022

Në lidhje me pikën e parë në Rend të Ditës, Kryetari parashtron se ortaku Balfin ka shprehur vullnetin e tij për dal nga Shoqëria nëpërmjet revokimit të vendimit të Asamblese së Përgjithshme të Shoqërisë me datë 15.06.2022, i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me datë 24.06.2022 me CN- 931616-06-22. Rrjedhimisht Kryetari propozon Asamblese të miratojë revokimin e vendimit të Asamblese së Përgjithshme të Shoqërisë me datë 15.06.2022 dhe zvogëlimin e kapitalit të saj me një vlerë prej 3.025.597 Lekë e cila i korrespondon kontributit të nënshkruar dhe paguar nga Balfin në zmadhimin e kapitalit të miratuar me vendimin në fjalë.

Pas një vlerësimi të kujdesshëm, Asambleja:



VENDOS:

-1-



1. Të miratojë revokimin e vendimit të Asamblese së Përgjithshme të Shoqërisë me datë 15.06.2022, i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me datë 24.06.2022 me CN- 931616-06-22, bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Të miratojë, për rrjedhojë, daljen e ortakut Balfin nga Shoqëria dhe kthimin e kontributit të dhënë prej tij në Shoqëri, duke zvogëluar kapitalin e saj me një vlerë prej 3.025.597 LEK (tre milion e njëzet e pesë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë lekë).
3. Kapitali i Shoqërisë pas zvogëlimit të miratuar mësipër do të jetë në vlerën totale prej 27.230.375 LEK (njëzet e shtatë milion e dyqind e tridhjetë mijë e treqind shtatëdhjetë e pesë lekë), nënshkruar dhe kontribuar nga Ortakët si vijon (i) Marina di Valona SH.P.K. 80% të kapitalit me vlerë kontributi 21.784.300 LEK (njëzet e një milion e shtatëqind e tetëdhjetë e katër mijë e treqind) Lekë dhe (ii) Brunesh SH.P.K. 20% të kapitalit me vlerë 5.446.075 LEK (pesë milion e katërqind e dyzet e gjashtë mijë e shtatëdhjetë e pesë lekë).
4. Të autorizojë Administratorin që në emër dhe për llogari të Shoqërisë të kryejë të gjitha aplikimet e nevojshme me qëllim regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, personalisht ose nëpërmjet autorizimit të personave të tjerë për këtë qëllim.

* * * * *

Meqenëse nuk kishte çështje të tjera për t'u shqyrtuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur. Ky Vendim i Shoqërisë, i mbajtur në formën e procesverbalit, nënshkruhet rregullisht në përputhje me parashikimet e nenit 90/3 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, nga Sekretari dhe Kryetari i Mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE TË SHOQËRISË "Marina Residences Vlorë" SH.P.K

Listë Prezenca

EMRI	CILËSIA	POZICIONI NË ASAMBLE
Eranda Muskaj	Përfaqësues ligjor i Ortakut Marina di Valona SH.P.K.	Kryetar
Geront Çela	Përfaqësues ligjor i Ortakut Brunesh SH.P.K.	Anëtar
Edlira Muka	Përfaqësues ligjor i Ortakut BALFIN - Balkan Finance Investment Group SH.P.K.	Anëtar
Itena Ndroqi	Konsulent ligjor	Sekretar

BALFIN
BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP
BALFIN sh.p.k.
Rruga "Papa Gjon Pali II",
ABA Business Center, Kati II, Tiranë
Nipt: K72223031K

FIRMA
MARINA DI VALONA
MO1324008A

BRUNESH sh.p.k.
K37125203H24
Durrës - Albania

Eranda Muskaj

Edlira Muka

Itena Ndroqi

